

Mbështetja për Profilin e Instaluesit të Sistemeve të Termohidraulikës

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE

1. MBËSHTETJA E PROJEKTIT NË PROFILIN E TERMOHIDRAULIKËS

- 1.1 Memorandumi i Mirëkuptimit, 8 maj 2009
- 1.2 Memorandumi i Mirëkuptimit, 20 qershor 2012
- 1.3 Fisha e projektit
- 1.4 Plani i rotacionit të nxënësve në vitin shkollor 2013-2014

2. QASJA E RE E TË NXËNIT BAZUAR NË PROJEKTE

- 2.1 Karakteristikat e të nxënit bazuar në projekte
- 2.2 Organizimi i projekteve të të nxënit në shkollat partnere të projektit
- 2.3 Hapat e zhvillimit të një projekti
- 2.4 Marrëdhënia mësues-nxënës
- 2.5 Realizimi i projektit
- 2.6 Përfundimi i projektit
- 2.7 Takimet analizuese

3. SKELET-KURRIKULAT DHE MATERIALET MËSIMORE

- 3.1 Skelet-kurrikuli i nivelit të parë dhe të dytë (klasat 10-12)
- 3.2 Skelet-kurrikuli i nivelit të tretë (klasa 13)
- 3.3 Projekti i të nxënit Nr. 1
 - Përgatitja e elementëve tipikë të sistemeve të tubacioneve me anë të veglave të dorës
- 3.4 Projekti i të nxënit Nr. 2
 - Përgatitja dhe instalimi i sistemeve të thjeshtë të tubacioneve
- 3.5 Projekti i të nxënit Nr. 3
 - Instalimi i sistemeve të furnizimit me ujë dhe shkarkimit të ujrave
- 3.6 Projekti i të nxënit Nr. 4
 - Instalimi i pajisjeve të gjenerimit të nxehtësisë dhe sistemeve të shpërndarjes së ngrohjes
- 3.7 Projekti i të nxënit Nr. 5
 - Instalimi i pajisjeve të ngrohjes së ujit dhe sistemeve të shpërndarjes së tij si dhe pajimi i banjave, dusheve dhe tualeteve me pajisje dhe rubineteri
- 3.8 Projekti i të nxënit Nr. 6
 - Instalimi i plotë sanitar dhe i sistemit të ngrohjes të një apartamenti

3.9 Projekti i të nxënit Nr. 7

- Montimi dhe dorëzimi i sistemeve sanitare dhe të ngrohjes

3.10 Projekti i të nxënit Nr. 8

- Dimensionimi (projektimi) i sipërfaqeve ngrohëse

3.11 Projekti i të nxënit Nr. 9

- Projektimi, montimi dhe prezantimi i instalimeve sanitare komplekse

3.12 Projekti i të nxënit Nr. 10-1

- Projektimi, llogaritja dhe montimi i sistemeve të paneleve diellore (pjesa I)

3.13 Projekti i të nxënit Nr. 10-2

- Projektimi, llogaritja dhe montimi i sistemeve të paneleve diellore (pjesa II)

3.14 Projekti i të nxënit Nr. 11

- Projektimi, llogaritja dhe montimi i sistemeve të paneleve diellore për përgatitjen e ujit të ngrohtë sanitar dhe me ngrohje shtesë nga kaldaja

4. PROVIMET PËRFUNDIMTARE

4.1 Model provimi niveli 1

4.2 Model provimi niveli 2

4.3 Model provimi niveli 3

5. FAKTE DHE SHIFRA

HYRJE

Fondacioni zviceran Swisscontact ka mbështetur vazhdimisht reformën në sistemin e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Shqipëri qysh nga viti 1994 nëpërmjet projekteve të ndryshme. Veçoria dalluese e këtyre projekteve ka qenë lidhja e tyre me botën e punës, të mësuarit praktik duke synuar raportin 50% teori dhe 50% praktikë në të gjitha profilet e mbështetura, si dhe qasjet inovative, të cilat janë mirëpritur nga partnerët e projektit në të gjitha nivelet, si në atë qendror ashtu dhe në nivelin shkollor.

Një vlerësim i jashtëm i kryer në Qershor 2010 i cilësoi projektet zvicerane si ndër projektet më me ndikim në sektorin shqiptar të AFP-së, ata janë tepër të vlerësuar e gëzojnë mirënjohje të plotë nga partnerët dhe autoritetet shqiptare. Një studim i kryer nga vlerësues të jashtëm në tremujorin e parë të vitit 2014 mbi situatën aktuale të ofruesve të AFP tregoi se ofruesit e trajnimeve që janë mbështetur nga Qeveria Zvicerane konsiderohen sot ndër më të mirët në vend.

Bazuar në arritjet, besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e rezultateve të projekteve të mëparëshme, projektit AlbVET, filluar në vitin 2007 me financim nga SDC, iu besua zhvillimi dhe implementimi i një metode krejtësisht të re në fushën e AFP, metoda e të nxënit bazuar në projekte. Kjo qasje mbulon të gjithë fushën profesionale të termohidraulikës dhe përfshin instalimet sanitare dhe ato të ngrohjes (niveli 1 dhe 2 i studimeve) si dhe specializimet e avancuara në instalimet komplekse sanitare dhe teknologjinë diellore (niveli 3 i studimeve).

1. MBËSHTETJA E PROJEKTIT NË PROFILIN E TERMOHIDRAULIKËS

Mbështetja për profilin e termohidraulikës u bë mbi bazën e një Memorandumi Mirëkuptimi ndërmjet Projektit AlbVET dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë, nënshkruar më 8 maj 2009, i cili u pasua tre vite më vonë nga Memorandumi i dytë i Mirëkuptimit, firmosur më 20 qershor 2012, për zhvillimin e specializimeve të avancuara në 4 qendra kompetencash.

Mbështetja e projektit në drejtimin e instaluesit të sistemeve termohidraulike ka konsistuar në:

- hartimin e një kurrikuli të ri mbështetur në metodën e të nxënësve bazuar në projekte (NBP);
- trajnimin e mësuesve dhe instruktorëve për të gjitha projektet e të nxënësve si dhe për përvetësimin e kësaj qasjeje të re në fushën e tyre të profesionit;
- hartimin e materialeve mësimore për 11 projektet e të nxënësve, nga viti i parë (klasa 10) deri në vitin e katërt (klasa 13) të studimeve;
- plotësimin e infrastrukturës së nevojshme për realizimin e këtij kualifikimi (repartet e reja të praktikës me pajisjet, veglat, instrumentat dhe materialet e konsumit) për 10 shkolla profesionale publike të vendit;
- hartimin dhe realizimin e specializimeve të avancuara në klasën 13, konkretisht instalimet komplekse sanitare dhe teknologjinë diellore, të cilat janë përqendruar në 4 shkollat më të mira ("qendra kompetencash");
- hartimin dhe implementimin e një forme të re të provimeve përfundimtare të nivelit 1, 2 dhe 3;
- hartimin e kornizës së nevojshme organizative dhe rregulluese.
- hartimin dhe realizimin e skemës së rotacionit të nxënësve të klasës 13, për specializimet e avancuara.
- nxitjen e pjesëmarrjes së sektorit privat nëpërmjet stazheve të punës në vitin e tretë të profilit të termohidraulikës, pjesëmarrjes së përfaqësuesve të sektorit privat në komisionet e vlerësimit të provimeve të të 3 niveleve si dhe mbështetjes financiare, me pajisje dhe me ekspertizë të iniciativës së sektorit privat për organizimin në tre vitet e fundit të olimpiadës kombëtare të aftësive profesionale.

Për implementimin, projekti AlbVET ka bashkëpunuar me 10 shkolla profesionale publike në të gjithë vendin, duke mbuluar në këtë mënyrë këtë profil në shkallë vendi.

Shkollat e përfshira janë:

- Shkolla Profesionale “Stiliano Bandilli” Berat
- Shkolla Profesionale “Beqir Çela” Durrës
- Shkolla Profesionale “Salih Çeka” Elbasan
- Shkolla Profesionale “Rakip Kryeziu” Fier
- Shkolla Profesionale “Thoma Papapano” Gjirokastër
- Shkolla e Ndërtimit Korçë
- Shkolla Mekanike e Lushnjës
- Shkolla e Ndërtimit “Kolë Idromeno” Shkodër
- Shkolla e mesme e Ndërtimit “Karl Gega” Tiranë
- Shkolla Industriale “Pavarësia” Vlorë

Specializimet e avancuara në instalimet komplekse sanitare dhe në teknologjinë solare janë përqendruar në 4 shkollat më të mira, të cilat shërbejnë si qendra kompetencash. Studentët e shkollave të tjera duhet t'i realizojnë projektet e të nxënimit të specializimeve të avancuara në këto 4 qendra, nëpërmjet një skeme rotacioni, e cila u zbatua për herë të parë me sukses në vitin shkollor 2012/13.

2. QASJA E RE E TË NXËNIMIT BAZUAR NË PROJEKTE (NBP)

Metoda e të nxënimit bazuar në projekte (NBP) është një formë e të nxënimit të orientuar nga veprimi dhe shërben si një mjet shumë i mirë për nxitjen e motivimit të brendshëm të nxënësve, për të zhvilluar mendimin e pavarur, për të zbatuar njohuritë e fituara, për të forcuar vetëbesimin dhe praktikuar përgjegjësinë sociale. Metoda NBP mund të përcaktohet si metodë e zgjidhjes praktike të problemeve, që kërkon nga nxënësit të kryejnë një punë të konsiderueshme konstruktive dhe të pavarur.

2.1 Karakteristikat e NBP

- Orientimi nga nxënësit (gjatë realizimit të projektit nxënësit kanë hapësira të mëdha veprimi dhe vendimmarrjeje, për të shfaqur interesat, idetë dhe përvojat e tyre).
- Orientimi nga realiteti (nxënësit merren me probleme komplekse dhe detyra të profesionit të tyre, që lidhen me situata reale të jetës së punës).
- Orientimi nga produkti (qëllimi dhe pika kyçe e punës me projekte është realizimi i një produkti konkret).
- Orientimi nga veprimi, ku kërkohet punë fizike dhe mendore.
- Vetëorganizimi dhe vetëpërgjegjësia e nxënësve.

- Të nxënit bashkëpunues (puna në ekip).
- Lidhja me jetën reale të punës dhe me përvojat që rrjedhin nga ajo.
- Planifikimi i orientuar nga qëllimi.
- Projekti shihet në tërësinë e tij: nuk vlerësohet vetëm produkti, por i gjithë procesi i punës.

2.2 Organizimi i projekteve të të nxënit në shkollat partnere të projektit

Me projekte të nxëni nxënësit zbatojnë në grup detyra tipike të drejtimit profesional përkatës. Ata kryejnë ciklin e plotë nga biseda me klientin, tek hartimi i konceptit, përgatitja e elementëve, instalimi, kontrolli dhe dorëzimi tek klienti.

Mbi bazën e kërkesës së një klienti virtual, nxënësit përgatisin si hap të parë një skicë dhe konceptin e instalimit. Pas miratimit, ata përgatisin një plan pune dhe vendosin për përgatitjen e elementëve në repartin e praktikës. Ata porosisin lëndën e parë të nevojshme, rakorderitë dhe pajisjet nga magazina, duke mësuar njëkohësisht si të menaxhojnë gjëndjen e stokut dhe inventarin. Në hapin tjetër nxënësit identifikojnë në grup veglat e nevojshme dhe i përgatisin ato për punë. Mësuesi vlerëson përgatitjen e veglave dhe sugjeron adaptime nëse nevojitet. Nxënësit vendosin për ndarjen e punës së instalimit dhe e kryejnë atë sipas planit. Ata bashkojnë elementët e parapërgatitur dhe gjejnë zgjidhje për problemet e instalimit që dalin gjatë procesit.

Mbas përfundimit të secilit hap dhe/ose projektit të plotë, nxënësit kontrollojnë instalimin dhe funksionimin e tij sipas kriteresh të parapërcaktuara si dhe dokumentojnë rezultatet. Mbas përfundimit të plotë të projektit të të nxënit, nxënësit ia paraqesin punën e tyre klientit virtual, përgatisin raportin e punës dhe kohën e shpenzuar, dhe shqyrtojnë e vlerësojnë në grup të gjithë procesin.

Secili projekt të nxëni përmban gjithashtu elemente teorike, të cilat integrohen në projektin e të nxënit.

Secili nga projektet e të nxënit ka një kohëzgjatje prej 1-2 muaj. Projektet zhvillohen në të tre nivelet: 6 projekte në nivelin 1 (3 në klasën 10 dhe 3 në klasën 11), 2 projekte në nivelin 2 (klasa 12) dhe dy projekte në nivelin 3 (klasa 13 – specializimet e avancuara). Për teknologjinë diellore janë zhvilluar 2 projekte, njeri për teknologjinë e thjeshtë diellore dhe tjetri për kombinimin e teknologjisë diellore me ngrohjen nga kaldaja.

Në nivelin 1 mësimi organizohet në blloqe javore, dmth. Nxënësit kryejnë një javë mësim në klasë dhe një javë projekte të nxëni. Me qëllim që të shfrytëzohet kapaciteti i plotë, është rekomanduar që mësimi të organizohet i alternuar në repartin e praktikës dhe në klasa teorie si vijon:



Në klasën 10 nxënësit zhvillojnë 18 javë mësim në klasë dhe 18 javë projekte të nxëni. Në klasën 11 ata zhvillojnë 16 javë mësim në klasë, 18 javë projekte të nxëni dhe 2 javë provime. Në nivelin 2 (klasa 12) mësimi organizohet si vijon:

Praktika në Biznes



Në klasën 12 nxënësit zhvillojnë 16 javë stazh pune në biznese, 14 javë mësim në klasë (rekomandohet të ndahet në një bllok me 4 javë dhe dy blloqe nga 5 javë secili), 2 projekte të nxëni me 2 javë secili dhe 2 javë provime. Stazhi i punës në biznese mund të zhvillohet i ndarë në blloqe, sipas mundësive që kanë shkollat dhe firmat ku do të zhvillohet stazhi.

Në klasën 13 mësimi organizohet në blloqe, në të cilat nxënësit kryejnë mësimin teorik në klasë si dhe projektet e të nxënit në katër shkollat ku janë instaluar kabinetet përkatëse për realizimin e sistemeve të paneleve diellore dhe instalimeve sanitare komplekse.

2.3 Hapat e zhvillimit të një projekti

1. Informacioni dhe objektivat

- Hyrja në metodën e projekteve
- Synimi i projektit
- Bërja e skicës së projektit

2. Planifikimi dhe vendimmarrja

- Mbledhja e informacioneve dhe strukturimi i projektit
- Vendosja e rregullave të lojës
- Përcaktimi i rrugës së zgjidhjes dhe zgjedhja e metodave të përshtatshme
- Përpunimi i planit të projektit

3. Realizimi

- Zbatimi i detyrave në grupe të vogla dhe punët individuale
- Puna e pavarur dhe e përgjegjshme e nxënësit
- Kontrolli i rregullt i rezultateve të ndërmjetme dhe krahasimi me planifikimin.
Korigjimet eventuale

4. Përfundimi/Reflektimi

- Kontrolli i përbashkët, diskutimi dhe vlerësimi i rezultateve të projektit
- Thellimi teorik dhe praktik i temave të veçanta
- Vlerësimi i përvojës së të nxënit
- Sqarimi i lidhjeve midis teorisë dhe praktikës

2.4 Marrëdhënia mësues-nxënës

Angazhimi në realizimin e hapave të sipërpërmendur të projektit bën të qartë që para mësuesit dhe nxënësit dalin detyra krejtësisht të reja, që ndryshojnë thelbësisht nga mësimi tradicional dhe që ndikojnë në marrëdhëniet mësues-nxënës.

Mësimi me projekte nuk zhvillohet as me mësuesin në qendër as me nxënësin në qendër, por është një mësim integruar social, ku pjesëmarrësit, edhe pse me kompetenca të ndryshme, bashkëpunojnë në një projekt të përbashkët.

Njëkohësisht, gjatë të nxënësve me projekte të dy palët rriten potencialet dhe mundësitë në fitimin e kompetencave.

Në mësimin me projekte mësuesi ka detyrën e organizimit, gjë që i jep atij mundësinë t'u transmetojë nxënësve kompetencat e tij pedagogjike dhe profesionale. Nga ana tjetër nxënësit, me ndihmën e mjeteve moderne të komunikimit, mund të kapin një spektër të gjerë të dijeve dhe informacionit. Megjithatë mësuesi, si ekspert profesional dhe pedagogjik, ka përgjegjësinë për të gjithë procesin. Ai duhet ta ndjejë se kur është i nevojshëm integrimi dhe kur kërkohet të nxënësve të pavarur. Pra mësuesi është drejtues që merr pjesë në të gjithë procesin.

Për sa u përket nxënësve, atyre u kërkohet të heqin dorë nga qëndrimi pasiv dhe pritës, dhe të jenë aktivë për të fituar dhe zbatuar kompetenca të ndryshme. Kompetenca e të punuarit me projekte duhet të vlerësohet si nocion kryesor që përfshin kompetencat e pjesëme të mëposhtëme:

- Kompetenca e bashkëpunimit që lidhet me punën në ekip.
- Kompetenca e komunikimit për krijimin dhe mbajtjen e kontakteve, për reflektim të përbashkët dhe punën në projekt.
- Kompetenca e organizimit, si pjesë e kompetencës metodike në procesin e planifikimit.
- Kompetenca e prodhimit që lidhet me produktin që duhet prodhuar.
- Kompetenca që lidhet me aftësinë e nxënësve për vetëvendosje, vetëreflektim dhe për të qenë të pavarur.
- Kompetenca didaktike, e cila synon t'i aktivizojë nxënësit jo vetëm në rolin e të nxënësve, por edhe të mësuarit, kur ata i prezantojnë produktet e tyre në publik.
- Projektet kërkojnë personalitet të plotë të pjesëmarrësve.

2.5 Realizimi i projektit

Nuk ka kufij fiks midis planifikimit të projektit dhe realizimit të tij. Pjesëmarrësit në një projekt bien dakord për një produkt të përbashkët dhe më pas përpunohen ta realizojnë atë. Veprimi konkret, bashkëpunimi dhe përqendrimi në një produkt të përbashkët janë pikë referimi për çdo reflektim dhe distancim. Kjo e bën të qartë dallimin nga mësimi i zakonshëm.

Gjatë realizimit të një projekti një rol të veçantë luan puna në grup. Aftësia për të punuar në grup në mënyrë të pavarur dhe pa mbikëqyrje kontrolluese, është shpesh kualifikim

kyç për projektet. Dështimi i projekteve lidhen shpesh me mungesën e përvojës për të punuar në grup.

Një punë efektive përgatitore për projektet është ushtrimi i punës në grup gjatë zhvillimit të mësimin të lëndëve profesionale.

2.6 Përfundimi i projektit

Në rastin tonë, qëllimi përfundimtar është një rezultat i dukshëm, pra një produkt. Në çdo rast, për mbylljen e projektit pjesëmarrësit duhet të bien dakord, sikurse edhe në fillimin e tij.

2.7 Takimet analizuese

Takimet analizuese brenda një projekti kanë para së gjithash rëndësi organizative. Ato, mes të tjerash, u shërbejnë pjesëmarrësve:

- për të shkëmbyer informacione për aktivitetet e tyre,
- për të përgatitur dokumentacionin lidhur me fazën e fundit të ecurisë së projektit,
- për të organizuar hapat e mëtejshme,
- për të analizuar gjendjen e punës krahasuar me objektivat e planifikuara.

Këto takime zhvillohen nëse një apo disa pjesëmarrës kanë përshtypjen se

- ata nuk e dinë sa duhet se çfarë bëjnë të tjerët ose çfarë duhet të bëjnë ata vetë,
- nuk orientohen lehtë,
- ndodhen nën presionin e kohës.

3. MATERIALET MËSIMORE

Metoda NBP është realizuar në shkollat e projektit, mbështetur në skelet-kurrikulat përkatëse të nivelit 1-2 dhe të nivelit 3, të cilat janë miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Për të gjitha projektet e të nxënësve janë hartuar materialet përkatëse mësimore, të cilat përmbajnë:

- Planin mësimor teorik të projektit përkatës
- Planin mësimor të praktikës profesionale
- Listën e materialeve të nevojshme për realizimin praktik të projektit
- Skemën e instalimit që do të realizohet nga nxënësit
- Të gjitha përmbajtjet e komponenteve të veçanta të projektit, me ilustrimet dhe shpjegimet përkatëse
- Llogaritje dhe trajtime teorike të nevojshme për tema të veçanta.

Materialet mësimore janë përgatitur nga ekspertët ndërkombëtarë, të cilët i kanë trajtuar ato në seminarët e trajnimit të mësuesve dhe instruktorëve të termohidraulikës. Më pas ato janë sistemuar nga zyra e projektit dhe u janë shpërndarë të gjitha shkollave partnere.

4. PROVIMET PËRFUNDIMTARE

Këto janë pjesë integrale e metodës NBP dhe janë hartuar për të tre nivelet e termohidraulikës: niveli 1 (klasa 11), niveli 2 (klasa 12) dhe niveli 3 (klasa 13), i cili është kombinuar me provimet e maturës profesionale. Në provimet e çdo niveli kontrollohen dhe certifikohen njohuritë, aftësitë, shprehitë dhe kompetencat e nxënësve. Provimi përmban:

- testin teorik me shkrim, së bashku me planifikimin (skicimin e planit të instalimit) dhe listën e materialeve të nevojshme për realizimin e projektit praktik;
- punën praktike në grup;
- punën individuale për secilin nxënës;
- bashkëbisedimin profesional;
- kriteret e vlerësimit.

Provimi zgjat përgjithësisht 2 ditë: testi teorik zgjat 2 deri 3 orë, kurse provimi praktik 9 orë. Në komisionet e provimit marrin pjesë, përveç mësuesve dhe instruktorëve të caktuar sipas udhëzimeve përkatëse të Ministrisë, edhe përfaqësues nga sektori privat.

Pas asistencës nga ana e projektit AlbVET në provimet e 3 niveleve në përfundim të viteve shkollore 2010/11, 2011/12 dhe 2012/13, ato po zbatohen tani me sukses nga vetë shkollat partnere pa mbështetjen e projektit, gjë që është tregues i suksesit dhe jetëgjatësisë së kësaj qasjeje. Nga ana e Agjencisë Kombëtare të AFP dhe Kualifikimeve është shfaqur mjaft interes dhe dëshirë për zbatimin e këtyre metodave të testimit edhe në fusha të tjera profesionale.

5. FAKTE DHE SHIFRA

1. Mbulon të gjithë fushën profesionale të sistemit publik në profesionin e termohidraulikut, duke bashkëpunuar me 10 shkolla në qytete të ndryshme të vendit.
2. 36 mësues dhe instruktorë të termohidraulikës nga shkollat partnere si dhe nga Qendra e Lëvizshme e Trajnimit janë trajnuar nga ekspertë ndërkombëtarë për zbatimin e metodës së NBP dhe provimet e niveleve të ndryshme, me një numur total maksimal prej 90 ditësh trajnimi.
3. Numri total i pranimeve të reja është rreth 300 nxënës në vit.

4. Në qershor të vitit 2013 përfunduan ciklin e trajnimit 4 vjeçar 203 nxënësit e parë të termohidraulikës, të cilët kaluan me sukses provimin përfundimtar të nivelit 3.
5. Numri total i nxënësve përfitues (klasat 10-13 në vitin shkollor 2013/14 plus 203 nxënës që kanë përfunduar studimet në qershor 2013) është rreth 1300.
6. Një studim gjurmues nga AlbVET po identifikon nivelin e punësueshmërisë së nxënësve të termohidraulikës, pas përfundimit të ciklit 4 vjeçar të studimeve.
7. 10 shkolla profesionale si dhe Qendra e Lëvizshme e Trajnimit janë pajisur me repartet bazë të praktikës për termohidraulikën, kurse 4 shkollat më të mira janë pajisur me repartet përkatëse të specializimeve të avancuara në instalimet komplekse sanitare dhe teknologjinë diellore. Veç kësaj shkollat janë furnizuar nga projekti edhe me materialet e konsumit për realizimin e të gjitha projekteve të të nxënësve si dhe të provimeve përfundimtare në 3 nivelet. Vlera e përgjithshme e këtyre investimeve arrin në rreth 750'000 Euro.
8. Materialet mësimore të zhvilluara së bashku në trajnimin e mësuesve dhe instruktorëve, mbështesin direkt proceset e mësimdhënies dhe të të nxënësve dhe kjo gjë vlerësohet nga shkollat, mësuesit, instruktorët, si edhe nga nxënësit. Janë hartuar materialet mësimore për 11 projektet e të nxënësve, nga viti i parë (klasa 10) deri në vitin e katërt (klasa 13), me një numur total prej rreth 2000 faqesh.
9. Programet e rinovuara në degën e termohidraulikës, rritin në mënyrë të dukshme pjesëmarrjen e nxënësve në mësim dhe reduktojnë shkallën e braktisjes.
10. Metodatat e integruara me kurrikula të përshtatura, trajnimet e mësuesve dhe instruktorëve, materialet dhe pajisjet mësimore lehtësojnë qëndrueshmërinë.
11. Mbështetja e sektorit privat për realizimin e stazheve të punës në vitin e tretë, të pjesëmarrjes së përfaqësuesve të tij në komisionet e vlerësimit të provimeve, si dhe mbështetjes financiare, me pajisje dhe me ekspertizë të iniciativës për organizimin në tre vitet e fundit të olimpiadës kombëtare të aftësive profesionale. Në këtë olimpiadë kanë marrë pjesë çdo vit më shumë se 300 nxënës nga 24 shkolla, në 5 profile të ndryshme teknike. Bashkëpunimi me sektorin privat mbetet një sfidë e rëndësishme në stadin aktual të zhvillimit të ekonomisë shqiptare.